

Drejtuar: AKM-se Tirane  
Per dijeni: DRM-se Fier

## **KERKESE PER KONSULTIM ME PUBLIKUN PASTRIM KIMIK**



*Bazuar ne shtojcen 1 te ligjit Nr. 52/2020 per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar klasifikohet si aktivitet:*

*Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve*

*ID 7.12 I. Pastrimi kimik, me kapacitet te barabarte apo me shume se 1 ton/dite tekstile*

Vendodhja: Vlore, lagjja "Pavaresia", rruga "Gjergj Araniti", Pallati Nr.4.

Shoqeria "Wash & Go Laundry" sh.p.k

Luan Jashari

Administrator

Maj 2022

*Luan Jashari*  
WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA

## Hyrje


Kerkesa për pjesëmarrjen në organizimin e konsultimit me publikun dhe palet e interesuara hartohet për aplikim për leje mjedisi tipi B, **Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventeve ID 7.12 I. Pastrimi kimik, me kapacitet të barabartë apo më shumë se 1 ton/dite tekstile**, bazuar kjo në shtojcën 1 të ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.

Ky aktivitet zhvillohet nga shoqëria "Wash & Go Laundry" sh.p.k e regjistruar në QKB, me numër NUIS L97008205L me aktivitet në fushën e lavanterisë, ofrojnë edhe vërtetësim lavanteri, shërbime të ndryshme pastrimi, higjienizim, dezinfektim, hekurosje, pastrim të sipërfaqeve dhe materialeve të ndryshme, shërbim në ambientet e kerkuara, shërbime asistencë, etj.

Aktiviteti "Wash & Go Laundry" është instaluar në ambientet e katit të parë të një objekti shumë katesh të marrë me qira. Ndermjet shoqërisë dhe pronarit është lidhur një kontratë 5-vjeçare me Nr. repertori 290 dhe koleksioni 182, datë 14.02.2020. Objekti i kësaj kontrate i cili ka një sipërfaqe 155.83 m<sup>2</sup> e llojit Njesi, ndodhet në Zk 8603, Nr. pasurie 29/535-ND, vol.37, fq 237, lagjia "Pavaresia", Vlorë. Ambientet përdoren nga qiramarrësi me destinacion Magazin dhe Lavanteri.



WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - A.S.A.



Koordinatat e objektit ne sistemin Gauss Kruger:

Nr	X (East)	Y (Nord)
Pika	4371554.25	4481625.36

Objekti ndodhet ne Njesine Strukturore VL.UB.7.1221

Bashkia Vlore

Sistemi UB\_Urban

Nenkategori 1, A.2\_Zona banimi ne qendren e Qyteti

Perdorime te lejuara S.1\_Dyqane, Sherbime Personale, Qendra Lokale Multifunkionale / Evente Edukative | S.2\_Zone Hotelesh / Sherbime Turistike.

Kategoria 1 A.Banim

WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA



## KUADRI LIGJOR

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligji Nr. 52/2020, per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10 448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar.

Ligji Nr. 10440, date 23/01/2003 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 12/2015 date 26.2.2015 Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date 7.7.2011,  
"Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ligji Nr. 10448, date 14/07/2011 "Per lejet e mjedisit",

Ligji Nr.8897, date 16/05/2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr.9010, date 13/02/2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"

Ligji Nr.9587, date 20/07/2006 "Menaxhimin e integruar te burimeve ujore "

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise",  
ndyshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 8405, date 17/09/1998 "Per urbanistiken" ndryshuar me ligjet Nr. 8453, date  
04/02/1999 dhe Nr.8991, date 23/01/2003 dhe Nr.8682, date 07/11/2000"

Ligji Nr. 8652, date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore."

Ligji Nr. 9244, date 17/06/2004 "Per mbrojtjen e tokes bujqesore"

### Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM) dhe udhezime

VKM Nr.249, date 24.04.2003 "Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te  
elementeve te lejes mjedisore"

VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis  
dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te  
cilat kerkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret.

VKM Nr.686, date 29.7.2015 per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per  
zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te  
vendimit e deklarates mjedisore.

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.3, date 17.08.2004 "Per miratimin e listes se veprimtarive, formatimin e aplikimit, dhe rregullat e procedurat e dhenies se pelqimit dhe autorizimit mjedisor nga ARM.

Rregullore e Ministrise se Mjedisit Nr.1, date 17.08.2004 "Per pjesemarrjen e publikut ne procesin e vleresimit te ndikimit te mjedis."

Udhezimi i Ministrit te Mjedisit Nr.5, date 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore.

Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie."

Udhezim i Nr.2, date 21.05.2007 "Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e provedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga Agjencite Rajonale te Mjedisit."

Udhezim i Ministrit te Mjedisit Nr.1, date 07.01.2008 "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore.

Urdher i Ministrit te Mjedisit, Nr.429, date 17.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per pajisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit.

Gjate vitit 2011, jane miratuar edhe tre ligje te rendesishme per mjedisin:

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj eshte plotesisht i perafruar me Direktiven 2004/35/KE te Parlamentit Europian dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 "Mbi pergjegjesite mjedisore, parandalimin dhe riparimin e demeve te mjedisit" te ndryshuar"

Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"

Ky ligj eshte perafruar plotesisht me Direktiven 85/337/KEE te Keshillit, date 27 Qershor 1985 "Mbi vleresimin e efekteve te projekteve publike dhe private ne mjedis", te ndryshuar.


Ligji Nr. 10448, date 17.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Ky ligj eshte perafruar plotesisht me

Direktivat:

2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar te ndotjes", e ndryshuar

Direktiven 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 23 Tetorit 2001 "Mbi kufizimin e shkarkimeve te disa ndotesve ne ajer nga instalimet e medha me djegie"

Te tre keto ligje nuk kane hyre ende ne fuqi pasi eshte duke u pergatitur aktet e nevojshme nenligjore. Keto tre ligje hyjne ne fuqi ne Shkurt te vitit 2013



## PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjkti "Wash & Go Laundry" sh.p.k ka si qellim ofrimin e sherbimeve lavanderie ne qytetin e Vlores dhe me gjere. Paisjet me te cilat kryhen si lavatrice, rrula hekuroses kalendar si dhe tharse jane sherbime teknologjia me innovative, te importuara nga Alliance Laundry Sistem, Fabrike me qender ne France. Te gjitha paisjet jane te certifikuara sipas standarteve europiane te cilat i demostrojme me foto sipas etiketave.

Gjithashtu produktet te cilat ne lajme importohen nga fabrika Tintolav Itali te certifikuara EU.

### Proceset teknologjike

Procesi i larjes behet me ane te sistemit te pomave te instaluara, te cilat sipas programimit te inxhinierëve mer likuidet (detergjentet) me formulat e inxhinierëve (te Fabrikes Alliance Group Laundry Sistem,France).

Procesi i larjes perbehet nga tre etapa:

- ✓ Larja e pare, kryhet shkripezimi dhe heqjen e yndyrnave,
- ✓ Larja e dyte, kryhet shkripezimi dhe meret detegjenti lares,
- ✓ Larja e trete, meret dezinfektuesi dhe zbardhuesi

Ne perfundim kryhen dy shplarje ne te cilen meret dhe aroma.

Kapacitet larese eshte mbi 1 ton/dite.

Subjkti disponon aktualisht 5 lavatrice me kapacitete:

- Dy lavatrice me kapacitet 28 kg,
- Dy lavatrice me kapacitet 18 kg dhe 24kg.
- Nje barrier washer me kapacitet 36 kg te certifikuara per spitale, per infeksione apo pandemi.

Montimi i tyre eshte bere ne ambjentet nje dhome te kontaminuar, ku nga njera ane futen roba te papastra dhe te infektuara dhe nga ana tjeter dalin te pastara duke e ndare ambjentin nga pjesa tjeter e infektuar.

Sasia e rrobave ne dite qe lahen me barrier washer per nje periudhe kohe 14 ore eshte mbi 1 tone roba te infektuara.






Foto 1 Barrier washer

Gjithashtu sasia e rrobave ne dite qe lahen me 2 lavatricet e tjera me kapacitet 28kg eshte 56 kg/ore duke lare per 8 ore mbi 1 tone rroba.




Foto 2 Lavatrice

WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA



Pasi kryhet i gjithë procesi i larjes, rrobat kalojnë në procesin e tharjes me rrul të tipit kalander, ku në të njëjtën kohë kryhet dhe hekurosja e tyre.

Shoqeria disponon tre rrula të cilat funksionojnë me gaz dhe me korent. Dy rrulat që funksionojnë me gaz kanë një kapacitet tharje dhe hekurosjes së çarçafëve rreth 70kg/ore për secilin. Për 8 ore të dy rrulat thajnë dhe hekurosin një sasi çarçafësh mbi 1 tonë. Ndërsa rruli që funksionon me korent ka një kapacitet tharje dhe hekurosje rreth 95 kg/ore.




Foto 3 Rruli për procesin e tharjes dhe hekurosjes

Për kryerjen e procesit të tharjes përvëç makinerive të mesipermeve (rrulave) subjekti disponon dhe dy tharëse me gaz me kapacitete 45 kg dhe 25kg të cilat kryejnë ciklin për 15 min.

Me kryerjen e procesit të tharjes përfundon i gjithë cikli i larjes së rrobave të cilat sillen nga klientët dhe spitalet. Këto rroba pakëtohen nëpërkëmbës dhe mbahen në ambientet e lavanderisë deri në momentin kur klienti vjen i tërheq.




Foto 4 Tharëse për procesin e tharjes


Te gjitha pajisjet dhe makinerit jane te nje teknologjie moderne me nje klas anergjie te larte per kursimin e energjise. Gjithashtu gjate procesit te larjes keto pajisje dhe makineri kane nje vibracion shume te ulet per shkak te teknologjise se larte qe perfaqesojne.

Ne ambjentet e lavanderise jane kryer te gjitha instalimet hidraulike per furnizimin me uje te lavatriceve dhe barrier washing si dhe sistemi i tubacioneve per shkarkimin e ujrave ne perfundim te procesit te larjes se rrobave. Keto sisteme tubacionesh jane te lidhura me sistemin e kanalizimit te ujrave te ndotur urbane te zones.

Gjithashtu ne ambjentet e lavanderise eshte intasluar dhe sistemi i furnizimit me gaze per pajisjet te cilat perdorin gazin per funksionimin e tyre (tharese dhe rrula).



*Foto 5 Sistemi i tubave te furnizimit me detergjente dhe uje*



**Lenda e pare ;** Rroba te papastra dhe te infektuara.

**Produkti perfundimtar;** Rroba te pastra dhe te dezinfektuara.

**Lendet ndihmese:**

- Detergjent per larjen e rrobave ( detergjent lares, denzifektant, zbardhues, aromantizues, etj.) vijne te importuara nga jashte vendit tone.
- Energjia elektrike e cila merret nga rrjeti kryesor i shperndarjes se energjise elektrike te zones nepermjet kontrates qe shoqeria ka lidhur me OSHEE GROUP. Kjo energji sherben per venine ne pune te makinerive dhe pajisjeve te cilat sherbejne per kryerjen e proceseve teknologjike te larjes se rrobave.
- Furnizimi me uje kryhet nepermjet linjes kryesore te furnizimit me uje te qytetit te Vlores. Uji perdoret per kryerjen procesit te larjes se rrobave dhe kryerjen e nevojave personale te punonjesve.

WASH & GO laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA

## PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI

### Shtrirja gjeografike

Objekti i lavanderise ndodhet ne lagjen "Pavaresia", rruga "Gjergj Araniti", Pallati Nr.4, Vlore.


Qyteti i Vlores ndodhet ne qender te gjirit te Vlores. Fillon ne veri me kepin e Triportit dhe perfundon ne perendim me kepin e Gjuhezes ne Karaburun. Ka nje pozicion shume te favorshem gjeografik qe ka dalje te drejtperdrejte ne det me nje mbrojtje natyrore nga malet dhe kodrat. Kjo pozite e volitshme gjeografike perforcohet edhe per shkak te vendndodhjes midis rrugeve tokesore, detare dhe ajrore qe e lidhin lehtesisht me pjesen tjeter brenda dhe jashte vendit. Qyteti i Vlores eshte 147 km larg kryeqytetit, Tiranës, 72 km nga Italia (Kanali i Otrantos) dhe 77 milje nga ishulli i Korfuzit, Greqi. Vlora eshte e njohur per burime te shumta natyrore, biodiversitet te pasur dhe korridore ekologjike. Ne antikitet Vlora eshte quajtur Aulona dhe permendet ne shkrimet e historianeve te lashte. Nje kombinim i vlerave historike, arkeologjike dhe natyrore me plazhe dhe me nje klime te mrekullueshme, duke perfshire mundesine per ndertimin e qendrave turistike, ku do te perqendrohen aktivitetet te tilla si sportet e ujit ose peshkimi e ben Vloren nje potencial te madh per zhvillimin e turizmit dhe argetimit.

### Biodiversiteti

Vlora karakterizohet nga nje larmi llojesh floristike natyrore por edhe te kultivuara, nje larmi shume te pakt te llojeve faunistike kryesisht shtepiake e bujqesore si dhe te nje shumellojshmerie morfografie habitatesh. Eshte ne nje nivel te lart llojshmeria e gjallesave ne mjedisin tokesor e detar e qe kerkon sigurimin e nje niveli te larte te kushteve mjedisore .

Keta elemente mjedisore te zones ne fjale perbejne nje pasuri natyrore ekonomike dhe turistike me vlera te larta. Larmia gjeografike perfshin nje larmi habitatesh si ekosisteme me karakteristika specifike floristike e faunistike por qe ne kompleks eshte nje habitat natyror Vlonjat me vlera te larta mjedisore e per rrjedhim edhe per nje zhvillim te qendrueshem ekonomim per zonen e kurores se lagunes se Nartes, por njekohesisht edhe nje pasuri me vlere kombetare. Nderhyrja ne kontrollin e ketyre aktiviteteve qe po ushtrohen ne kete zone, e duke patur parasysh mbrojtjen e mjedisit si nje ekosistem kompleks nepermjet mosdotjes se saj ashtu sic eshte pershkruar ne projektin teknologjik te paraqitur me siper, nuk con ne impakte te nivelit te tjetersimit te gjeomorfografise ekzistuese dhe as te impaktit negativ ne mjedisin. Sigurisht si cdo nderhyrje ka dhe impaktin e vet negativ por qe ky impakt eshte ne nivele shume te vogela, praktikisht zero.

Njekohesisht nepermjet masave per zvogelimin e ndikimeve negative qe zbatohen gjate ketij aktiviteti bejme te mundur qe impaktet ne gjeomorfologjine si dhe gjeomorfografine e kesaj zone te jene shume minimale e praktikisht zero. Ruajtja dhe mireadministrimi i gjeomorfografise se zones ku behet ky aktivitet, nuk demton ne asnje menyre nivelin e tjetersimit te gjeomorfologjise e as te



gjeomorfografise se kesaj zone. E gjithë zona dallon për nga diversiteti i habitateve dhe pasuria në specie të flores dhe faunes. Shumë prej tyre kanë një status ruajtje ose janë të rrezikuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe rajonal. Në zonën e aktivitetit mund të themi që nuk ka larmi specie faunistike dhe floristike për arsye se kjo është një zonë e ndërtuar me banesa dhe aktivitete të ndryshme. Mund të themi që qyteti i Vlores është rang i gjere habitatesh tipike për zonat ligatinore: shkurre mesdhetare, dhe makia në vargun e kodrave, pyjeve aluviale që kufizojnë lumin Vjose, zona me uje të fresket në kodrat e Zverneçit ose Panajase, lagunat bregdetare të Nartes e Kallenges, fushat e kripura të Akernise etj. Pasuria e habitateve shpjegon dhe prezencën e një numri të madh specimesh vertebroresh dhe jo-vertebroresh të tilla si zogj, gjitare, zvarranike, insekte dhe peshq.

### Flora

Flora dhe vegjetacioni është shumë e pasur dhe interesante. Për zonën njihen rreth 1,400 vascular plant species (baraz me 42.4% të flores Shqiptare). Të gjitha këto specie bimesh përbejnë një pasuri të madhe kombëtare. Disa prej tyre janë shumë të rralla, disa të tjera kanë vlera shkencore, një numër i madh i tyre përdoret si bime mjekësore, aromatike, industriale, ushqimore dhe dekorative.

Narta strehon XX taxons të rrezikuara në shkallë kombëtare

Tabela .Bime të rrezikuara në zonën e Vjose-Nartes

Taxon	Statusi i rrezikut	Shpërndarja
Origanum vulgare	EN	Në makiat mesdhetare dhe pyjet
Orchis sp	EN	E gjithë zona
Olea europea var. sylvestris	VU	Në makiat medhetare dhe pyjet
Cerantonia siliqua	EN	Në makiat medhetare dhe pyjet

Rreth 25 specie bimesh ose 7.5% të numrit total të specieve bimore të rrezikuara të Shqipërisë (330 specie në total) takohen në kompleksin e ligatinave. Mes tyre, 9 specie janë të rrezikuara në shkallë lokale ndërsa dy specie janë endemike për Shqipërinë

Tabela . Specie Bimesh të Rrezikuara në Shkallë Kombëtare dhe Lokale

No.	Emri Latin	Të rrezikuara	Vendndodhja
1	Agrimonia eupatoria L.	Rre	
2	Ammophila arenaria (L.) Lb.	Rre	
3	Anacamptis pyramidalis (L.) Rich.	Rre	
4	Baldellia ranunculoides (L.) Parl.	D, R	
5	Butomus umbellatus L.	D	

6	<i>Cladium mariscus</i> (L.) Pol.	D	
7	<i>Desmazeria marina</i> (L.) Drude.	Rre, R	Vjosa –Treport
8	<i>Elymus farctus</i> P.B.	Rre	
9	<i>Ephedra distachya</i> L.	Rre, R	Vjosa -Treport
10	<i>Hydrocotyle vulgaris</i> L.	Rre	
11	<i>Hypericum perforatum</i> L.	Rre	
12	<i>Marsilea quadrifolia</i> L.	D, R	Zverrnec
13	<i>Narcissus poeticus</i> L	R	
14	<i>Nuphar lutea</i> (L). Sibth.& Sm.	D, R	Vjosa e Vjeter
15	<i>Nymphaea alba</i> L.	D, R	Vjosa e Vjeter
16	<i>Nymphoides peltata</i> O.Kuntze.	D, R	
17	<i>Orchis albanica</i> Goelz & Reinhard.	Rre, End	Poro
18	<i>Orchis coriophora</i> L	Rre	
19	<i>Orchis x paparisti</i> Goelz & Reinhard	Rre, End	Poro
20	<i>Origanum vulgare</i> L.	Rre	
21	<i>Pancratium maritimum</i> L.	Rre, R	Zverrnec
22	<i>Quercus robur</i> L.	Rre.x?	Poro
23	<i>Serapias lingua</i> L.	Rre	
24	<i>Spiranthes spiralis</i> Koch.	Rre	
25	<i>Stachys maritima</i> L.	Rre	

E –te Rrezikuara, V- te Dobeta, R – Rralla. End- Endemike


Me interes te madhe eshte prezenca e dy specieve endemike: *Orchis albanica* dhe forma hybride *Orchis x paparisti*.

68 specie jane te konsideruara si te vlefshme ne zonen e Nartes per vlerat dhe interesin e tyre ekonomik dhe shkencor .

### Fauna

Sic thame dhe me lart, kompleksi i ligatinave Vjosa-Narta eshte nje zone e rendesishme me shperndarje te nje numri te madh kafshesh duke perfshire edhe molusqe, insekte, peshq, amfibe, reptile, gjitare dhe ne menyre te vecante zogj. Sipas studimeve te kaluara (Raporti i Diagnostikimit te Zones) kompleksi i ligatinave stehon te pakten 741 specie kafshesh ose vertebroresh (Tab. ).

Tabela . Kafshe prezentene kompleksin e ligatinave te Vjose-Narta



Group speciesh	Te rrezikuara Komb.	Te rrezikuara Glob.	Statusi i mbrojtjes	Nb. f species
Mollusqe	12	-		36
Insekte (Lepid & Coleopt)	57	1	28	287
Krustace	9	-		61
Echinoderms	6	-		6
Peshq	16	5	1	90
Amfibe	9	2	5	9
Reptile	23	5	20	26
Zogj	43	4	52	194
Gjitare	14	9	12	32
Total	189	26	118	741

Nje numer i madh speciesh i perket kategorive te rrezikuara ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Narta strehon 26 specie Globalisht te Rrezikuara (tabela X dhe X) per ketee arsye eshte nje zone ruajtja e te ciles eshte me interes ndeombetar. Per me teper kompleksi regjistron 174 specie qe perbejne njee shqetesim kombetare zhdukje dhe meritojne peepjekje kombetare per ruajtjen e zones. Rendesia e zones tregohet gjithashtu nga prezenca e 118 specieve tee mbrojtura ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Laguna e Nartes eshte nje pike e forte e biodiversitetit ne Shqiperi.

Tabela . Specie Globalisht te Rrezikuara

Nr.	Specie	Kategori Globalisht te Rrezikuara
1	<i>Lycaena ottomanus</i>	VU
2	<i>Acipenser sturio</i>	EN
3	<i>Alosa fallax nilotica</i>	DD
4	<i>Aphanius fasciatus</i>	DD
5	<i>Atherina boyeri</i>	DD
6	<i>Gambusia affinis</i>	EN
7	<i>Hyla arborea</i>	LRnt
8	<i>Triturus cristatus</i>	LRcd
9	<i>Caretta caretta</i>	EN
10	<i>Dermodochelys coriacea</i>	CR
11	<i>Elaphe situla</i>	DD

12	<i>Emys orbicularis</i>	LR/nt
13	<i>Testudo hermani</i>	LR/nt
14	<i>Pelecanus crispus</i>	LR/cd
15	<i>Haliaeetus albicilla</i>	LR/nt
16	<i>Aquila clanga</i>	VU
17	<i>Falco naumanni</i>	VU
18	<i>Rhinolophus blasii</i>	LRnt
19	<i>Rhinolophus euryale</i>	VU
20	<i>Rhinolophus ferrumequinum</i>	LRcd
21	<i>Myotis myotis</i>	LRnt
22	<i>Microtus (Pitymys) felteni</i>	LRnt
23	<i>Microtus (Pitymys) thomasi</i>	LRnt
24	<i>Mus spicilegus (abbotti)</i>	LRnt
25	<i>Lutra lutra</i>	VU
26	<i>Stenella coeruleoalba</i>	LRcd

Ex – Te zhdukura;

CR – Ne rrezik Kritik;

EN – ne Rrezik;

VU – te dobeta;

DD – mungojne te dhena;

LR/cd – Rrezik me i Vogel varen nga ruajtja;

LRnt - Rrezik me i vogel gati te rrezikuara;

### Amfibe dhe Reptile

Disa nga speciet jane te rrezikuara ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Eshte me vlere te permendet prezenca e specieve Globalisht te rrezikuara te Bretkoses se pemes Europiane Hyla arborea, Loggerhead Caretta caretta, breshka e tokes Testudo hermanni

### Zogj

Te dhenat e vitit te kaluar tregonin Narten si zonen e dyte me te rendesishme per zogjte e ujit ne Shqiperi, me Karavastane ne vend te pare. Ne dimer me shume se 23% e te gjithë zogjve te ujit Shqiptar strehoen ne zone. Per me teper se 35 specie zona mban me shume se 6% te numrit kombetar (Tabela ). Per Flamingo *Phoenicopterus ruber roseus*, Shelduck *Tadorna tadorna*, Pintail *Anas acuta*, Goldeneye *Bucephala clangula*, Kentish Plover *Charadrius alexandrinus* dhe Golden Plover *Pluvialis squatarola*, Narta eshte zona dimeruese me e madhe ne Shqiperi. Eshte me vlere permendja e prezences se





Pelikanit Kacurrel *Pelecanus crispus* (9%) dhe Audouini's Gull *Larus audouinii* (100%), te dyja specie te konsideruara Globalisht te Rrezikuara

Tabela . Rendesia Kombetare e Nartes per zogj uji dimerues informacion kombetar (Bino te papublikuara)

Specie	Kombetare %
<i>Podiceps cristatus</i>	15.40
<i>Phalacrocorax carbo</i>	19.02
<i>Pelecanus crispus</i>	8.97
<i>Ardea cinerea</i>	14.29
<i>Phoenicopterus ruber roseus</i>	50.85
<i>Anser albifrons</i>	31.58
<i>Tadorna tadorna</i>	41.18
<i>Anas penelope</i>	35.10
<i>Anas crecca</i>	29.57
<i>Anas platyrhynchos</i>	20.60
<i>Anas acuta</i>	42.16
<i>Anas clypeata</i>	17.30
<i>Aythya ferina</i>	8.50
<i>Bucephala clangula</i>	42.34
<i>Mergus albellus</i>	16.67
<i>Mergus serrator</i>	16.15
<i>Fulica atra</i>	21.96
<i>Haematopus ostralegus</i>	21.62
<i>Vanellus vanellus</i>	21.73
<i>Charadrius hiaticula</i>	14.29
<i>Charadrius alexandrinus</i>	53.68
<i>Pluvialis apricaria</i>	66.59
<i>Pluvialis squatarola</i>	35.66
<i>Calidris minuta</i>	41.73
<i>Calidris alpina</i>	41.72
<i>Numenius arquata</i>	7.76
<i>Tringa erythropus</i>	9.03
<i>Tringa totanus</i>	31.57
<i>Tringa nebularia</i>	13.56
<i>Tringa ochropus</i>	26.47

Actitis hypoleucos	6.45
Larus melanocephalus	12.09
Larus ridibundus	28.37
Larus genei	16.41
Larus audouinii	100.00
Specie Totale	23.50

Per tre specie folenizuese (Tab. ), Kentish Plover Charadrius alexandrinus, Black-einged Stilt Himantopus himantopus dhe Avocet Recurvirostra avosetta, Narta eshte zona me e reedesishme ne Shqiperi. Per speciet e tjera, Narta eshte zona e dyte me e rendesishme ne vend.

Tabela . Rendesia Kombetare e Nartee per zogj uji folenizues

Proporcione te shifrave kombetare sipas Tempelman & Defos du Rau 1998

Specie	Kombetare %
Charadrius alexandrinus	50
Himantopus himantopus	100
Recurvirostra avosetta	60
Burhinus oedicnemus	30
Glareola pratincola	25
Sterna hirundo	10
Sterna albifrons	40

Biodiversiteti i kesaj zone nuk do te demtohet nga presionet njerezore.

Ne piken e tregetimit me pakice te karburanteve dhe lubrifikanteve nuk ka praktika te papershtashme si shpyllezim e asnje lloj tjetër praktike demtuese te cfaredo lloji.

Nuk ka shkaktim te gryerjeve e rreshqitjes e tokes.

Lidhur me floren e ne vecanti te asaj perreth zones ne menyre te pergjithshme mund te themi se nuk dallohet per nje pasuri me vlera te vecanta pasi aty eshte nje zone e ndertuar me banesa dhe aktivitetete te ndryshme.

Duke u munduar per te paraqitur nje inventarizim te bimesise mund te rendisim keto lloje bimesh:

Bime te familjes Graminaceae, bime barishtore te dominuara nga lloji i Grami, por dhe bime si lloje zambakore si dhe bime te tjera njevjecare e shume vjecare te pa determinuara.

Bime Konifere, gjinia Pinus me llojet P, nigra, P halepensis, gjinia Abies-(bredhat), A Alba, gjinia Cupresus me llojin C, Sempervirens, dhe bime te tjera me popullime shume te vogla dhe pa ndonje



rendesi të vecante qofte ekonomike, mjekesore apo dhe studimore .Ka gjithashtu edhe një larmi bimesh dekorative sidomos të luleve të shumëllojshme e të pa përcaktuara si lloje.

Nuk ka bimë të rendesise se vecante apo bimë në rrezik të zhdukjes.

Nga pikpamja e llojshmerise se faunes konstatohet se persa i perket gjallesave të invertebroreve janë po ato të gjithë qytetit, por duhet vënë në dukje se popullata e llojeve invertebrore janë të vogla pasi ky fakt lidhet me parametrat e faktoreve ekologjike që janë më të pafavorshëm pasi kjo gjë është e shkaktuar nga vetë urbanizimi i një qyteti. Larmia e llojeve të vertebroreve është perseri relativisht e ulët për faktin se kushtet e shfrytëzimit të tyre është shumë i vogël e kjo për arsye të një qyteti urban sic është Vlora. Shumica e faunes paraqitet me popullata të vogla por që urbanizimi i qytetit ndikon direkt në mos mbijetesën e llojeve natyrore dhe në mos mbareshtimin e atyre të kultivuara. Persa i perket popullatave të flores dhe faunes detare themi se ato janë të larmishme e në vecanti të asaj ihtike por se rezervat e këtyre popullatave janë në kufij minimal dhe si pasoje ndikim në to është paraprakisht zero.

## Klima dhe hidrologjia

- Klima

Zona në studim ndodhet në Ultesirën Perëndimore të Shqipërisë dhe si e tillë ajo karakterizohet nga fusha klimatike Qendrore Mesdhetare. Dimri është pergjithesisht i butë, me rreshje të shumta ndërsa vera e nxehtë dhe e thatë. Rreshjet bien kryesisht në formën e shiut. Rreshjet e borës janë tepër të pakta dhe me kohezgjatje shumë të shkurtra. Rrezatimi diellor si një nga faktorët klimatike kryesore është mjaft uniform në të gjithë zonën. Vlera vjetore mesatare e rrezatimit diellor është 1540 kWh/m<sup>2</sup>. Vlera më e lartë regjistrohet në Korrik (216.5 kWh/m<sup>2</sup>) ndërsa ajo më e ulët në Dhjetor (52.1 kWh/m<sup>2</sup>). Temperatura mesatare vjetore varion nga 15.4 °C në Llakatund deri në 16.3 °C në Vlorë. Temperatura maksimale vjetore kapet në Korrik/Gusht me 30.0 °C ndërsa minimalja në Janar

Tabela 1 Temperaturat

Temperaturat (°C)		
Maksimale	Minimale	Mesatare vjetore
30	4,8	15,4-16,3

Vlerat e lageshtise dhe rrezatimit diellor			
Karakteristika	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera mesatare/ Totali
Lageshtia (%)	62	69	66
Rrezatimi diellor (kEh/m <sup>2</sup> )	52.1	216.5	1540

WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA

Lageshtia e ajrit eshte e lidhur me temperaturen. Mesatarja mujore e lageshtise ndryshon nga 62 - 69 %, ndersa mesatarja vjetore eshte 66 %. Era kryesore eshte briza detare, teper e dukshme sidomos gjate veres. Stina e dimrit dominohet pergjithesisht nga era e lindjes me nje shpejtesi mesatare prej 3.5 m/s.

Drejtimi kryesor i eres eshte ai lindor (24.4 %) i ndjekur nga drejtimi veri-lindor (Fig. 2). Vera dominohet nga briza detare me drejtim perendimor. Drejtimi kryesor eshte ai veri-perendimor (17.6 %) dhe perendimor (9.4 %.) Shpejtesia mesatare e eres eshte perkatesisht 4.4 m/s dhe 5.2 m/s.

Per shkak te thellesise se kufizuar, regjimi termik i ujerave te lagunes eshte i ngjashem me temperaturen e ajrit. Uji i detit qe hyn ne lagune ka nje ndikim te madh ne regjimin termik, vecanerisht prane kanaleve te komunikimit. Temperaturat me te uleta ne lagune regjistrohen ne periudhen Dhjetor-Janar ndersa me te lartat ne Korrik-Gusht. Temperatura mesatare vjetore eshte 14.9 0C. Rreshjet mesatare ne zone kapin shifren e 892 mm ne vit. 80% e rreshjeve bien gjate periudhes se lagesht te vitit (Tetor-Maj) dhe vetem 20% gjate periudhes se thate (Fig. 3). Vlera mesatare vjetore e avullimit eshte 1 173 mm (56 % e saj gjate periudhes se nxehte te vitit). Kjo vlere tregon se avullimi eshte me i larte sesa rreshjet, fakt ky qe tregon qarte se ekosistemi ka nevojte per prurje ujore. zevendesonte rolin e nje pylli apo nje siperfaqeje ekuivalente te gjelber. Zonat me 4500 ore/vit mund te konsiderohen si zona te grades se 1 deri 3.


### - Hidrologjia

Zona urbane e Vlores ku kryen aktivitetin e saj kjo shoqeri nuk eshte e njohur per burime ujore natyrore. Ne kete zone nuk ka shfrytezim te rezervave ujore nentokesore me ane te pusetave si per perdorim familjar ashtu dhe per vaditje ne bujqesi. Me ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e kuptueshme se nevojat per ujin jane te domosdoshme dhe do te rritet konsumi i ujit por sasite e nevojshme nuk ndikojne ne rezervat ujore te ujit te pijshem per popullaten e qytetit.

Burimet ujore natyrore ekzistuese te qytetit perdoren per furnizimin me uje te pijshem te qytetit te Vlores, por mund te themi qe tepricat mund te shfrytezohen per perdorim urban.

Rruget e gjithe ujrave te burimeve natyrore aktualisht jane ne gjendjen e tyre sipas rrjetit hidraulik te qytetit dhe kjo veprimtari nuk ka asnje lloj ndikimi lidhur me demtimin apo me ndonje nderhyrje te pa ligjshme.

Nga ky aktivitet ne zonen e caktuar nuk ka asnje nderhyrje qe te devijojne rruget e shkarkimeve te ujrave urbane te qytetit.



Per te siguruar cilesine e ujrave si shkarkime pas perdorimit te tyre shoqeria detyrohet te siguroje te gjitha masat dhe proceset teknologjike qe te sigurojne ngarkesat e ujrave brenda normave te lejuara dhe pa perdorur kimikate te ndryshme.

Shkarkimet e ujrave siperfaqesore te ndotura te zones duke perfshire cdo aktivitet tjeter ndotes detyrimisht i nenshtrohen te gjitha masave teknologjike e ligjore per te siguruar nivelin e ndotjes brenda normave te lejuara.

### **Tokat, kategoria e tokes dhe gjeologjia**

Veprimtaria ne fjale nuk kerkon toke ne perdorim per asnje lloj aktiviteti, por e vetmja siperfaqe tokesore eshte ajo e instalimit te tendes, pompave, etj dhe e zyres se sherbimit. Ne siperfaqen e tij marrin pjese depozitimet me moshe te Miocenit e Pliocenit, kuaternare detare qe perfaqesojne strukturat e Ultesires Praneadriatike te perbera nga shkembinjte rrenjesore argjilo-alevreolitore, ranor e konglomerate, qe kryesisht jane te perhapur ne pjeset anesore te rajonit, kryesisht ne lindje te tij. Gjithashtu marrin pjese edhe depozitimet Kuaternare qe mbulojne pjesen fushore te rajonit te perfaqesuara nga sedimente detare te Pleistocenit dhe detare e kontinentale te Holocenit.

### **Stratigrafia**

#### *Sistemi Neogenik – N*

Depozitimet e sistemit neogenik perhapen ne pjesen lindore dhe jugperendimore te rajonit dhe perfaqesohen nga depozitimet e seksioneve te Miocenit dhe Pliocenit. Ato perbejne bazamentin ku vendosen depozitimet e kuaternarit dhe nuk jane objekt i studimit tone.


#### *Seksionit Miocen – Pliocen N1-N2*

Depozitimet e ketij seksioni jane te perfaqesuara me depozitime te nenseksionit te mesem dhe te siperm dhe perkatesisht te kateve Serravalian dhe Tortonian.

#### *Kati Serravalian – N12S*

Ne siperfaqe takohet ne rajonin e kodrave te Zvernecit nga Kepi i Triportit ne juge deri tek Kepi i Dajlanit ne veri. Ne rajon nuk zhvishet e gjitha prerja, mungojne pjesa e poshtme dhe maja e saj, kalimi per ne depozitimet e katit Tortonian (per efekt te pranise se shkeputjes tektonike).

Litologjikisht perfaqesohen nga pjesa e poshtme me ranore masive deri shtrese trasha te nderthurur nga shtresa te holla argjllash alevritike e mergelore. Ranoret paraqiten koker vogel e mesem, rralle koker trasha e me madhesi gravelitike. Kane ngjyre hiri, e vende vende me nuanca te murme. Verehen gjithashtu mbeturina bimore te qymyriзуara si dhe konkrecione hekurore.



Me sipër vijon normalisht pakua e argjilave dhe alevroliteve të nderthurura me shtresa të rralla ranoresh. Argjilat paraqiten alevritike e karbonatike dhe që kalojnë në mergele e alevrolite. Kane ngjyrë të murme në të gjelber, kompakte, shtresor ndryshem. Në pjesën e sipërme të kesaj pakoje vrehen shtresa ranoresh të shkruar ngjyrë hiri, në të murme e në të verdhe.

#### *Kati Tortonian – N13t*

Takohet në pjesën me lindore të kodrave të Zvernecit dhe pikerisht pranë fshatit Zvernec. Kontakti me depozitimet e nenshtrira është tektonik. Prerja përfaqësohet nga pako e ranoreve dhe gelqeroreve ranore litotamnike me ndershtresa argjilash. Ranoret paraqiten kokrriz vogël, tepër karbonate, ndërsa gelqeror-ranoret litotamnike janë tepër alevritike e argjilore. Këto nivele litologjike nderthuren nga argjila tepër karbonatike që kalojnë në mergele.

Bazuar në foraminiferet e takuar, përcaktohet moshë e tyre tortoniane e zonës faunistike *Globigerinoides obliquus extremus*,

#### *Kati Messinian – N13m*

Depozitimet mesiniane dalin në sipërfaqe në strukturën e Panajasë dhe në lindje të qytetit të Vlores ku dhe vërohet trashësia me e madhe e tyre. Prerja e plote e tyre në sipërfaqe nuk zhvishet, por është e hapur nga pusët e kerkimit të shpuar në këtë rajon. Përfaqësohen në pjesën e poshtme nga nderthurje të ranoreve me argjila hiri në të kalter, me shtresëzime të qarta. Në vijshmeri, me lartë vërohet prerja gipsmbajtëse ku dallohen dy paketa gipsesh të ndara nga një pako argjilo-alevritke. Prerja e Messinianit mbyllet me një pako argjilash e alevrolitësh me ndershtresa ranoresh.

#### *Seksioni Pliocenik – N2*

Perhapjen sipërfaqësore depozitimet e seksionit pliocenik e kanë në pjesën lindore të rajonit dhe janë të përfaqësuara litologjikisht në dy litofacie të emëtuara *suita Helmesi* dhe *Rrogozhina*.

#### *Suita Helmasi – H2H*

Takohet në sipërfaqe në strukturën e Panajasë dhe kodrat e Aliban-Akernisë. Shtrihet mbi depozitimet mesiniane herë herë me transgresion. Ato janë të përfaqësuara nga argjila masive, të hirta e me nuanca të kalterta që përmbajnë shtresa ranore dhe thjërza konglomeratësh sidomos në pjesën e poshtme të cilet paraqiten jo shumë kompakt.

Në pjesën me të sipërme të prerjes shtohet prania e alevroliteve dhe ranoreve gati gradualisht për të kaluar në *suitën Rrogozhina*.

#### *Suita Rrogozhina - N2Rr.*

Depozitimet e suites Rrogozhina kanë përhapje të madhe në strukturën e Panajase. Vendosen suksesivisht mbi depozitimet e suites Helmesi.

Në rajonin e Panajase përfaqësohet nga ndërthurje të ranoreve të hirtë e verdhacake, të shkrifet, kokrriz vogël, me argjila karbonatike e alevritike dhe që vende vende kalojnë në mergele.

#### *Sistemi Kuarternar – Q*

Depozitimet kuarternare përhapen në sipërfaqen me të madhe të rajonit, ato mbulojnë strukturat antiklinale dhe sinklinale të ultesirës Pranadriatike. Bazuar në të dhenat fushore ku jemi mbeshtetur në kampionet e zgjedhur në zhveshje sipërfaqësore dhe në dheun e nxjerre nga kanalet e bonifikimit të fushës që i perkasin pjesës 2 deri 3 m në sipërfaqen akuale të tokës dhe mendojmë se përfaqësojnë sedimentet kuarternare të formuara në kondita detare.

Prezenca në rajon e depozitimeve të Pleistocenit dhe Holocenit faktohet nga analizat paleontologjike të kampioneve të analizuara. Megjithatë në rajon është shpuar një numur i madh pusesh me qelime hartografimi, strukturale, kerkim uji të pijshëm, kerkim gazi metan. Këto shpime na kanë siguruar vetëm të dhëna litologjike; në mjaftë raste daljen nga depozitimet e Kuarternarit, ndërsa të dhenat për argumentimin moshor të tyre janë të pakta.

#### **Zonat e Mbrojtura**

Zonat e mbrojtura në afërsi të objektit janë:

##### *Zverneci*

Ndodhet në pjesën veri-lindore të Vlores. Monumentet e mbrojtura të ndërtuar brenda këtij ishulli janë Manastiri i Zvernecit dhe Kisha e Manastrit, të cilat mbartin vlera të mëdha historike, kulturore. Përveç monumenteve, Zverneci është shpallur në teresi si një zonë e mbrojtur, ku spikat natyra e gjelbër, ndërtimet në brendësi, si dhe qasja e këtij ishulli me ujë.

##### *Manastiri i Zvernecit*

Në Zvernec ndodhet Manastiri në të cilin mund të gjejme gjithashtu Kishën e Shen Merisë monument kulture bizantin e shek. XIV. Kjo kishë ndodhet në ishullin piktoresk të Zvernecit në lagunen e Nartës. Kjo kishë i takon shekullit të 31-të. Është e tipit kryq me kupole të nartës. Në ambientet e brendshme të saj ruhen fragmente të pikturës murale e altari i gdhendur në dru zbukuruar me motive me lule e kafshe. Vlerë origjinale kishes i jep edhe hajati i shtruar me plake guri e që në anën veriore merr dritë nga shtatë harqe të mbështetura në kollona guri. Kisha është restauruar dhe është monument kulture. Kisha e Shen Merisë shërben si vend lutjeje, behen ceremoni fetare ortodokse si dhe çdo vit kujtohet 15 gushti, ditëlindja e Shen Merisë.

### *Kisha e Manastirit te Zvernecit*

Kisha eshte e tipit: kryq i lire me kupole, me narteks dhe ekzonarteks e nje hajat te hapur me kolonade ne anen veriore. Pjesa e vjeter perbehet nga naosi ne forme kryqi te lire me narteks, ndersa pjesa tjeter eshte shtuar me vone. Narteksi eshte drejtkendesh ne plan, me brinje me te gjate nga veri-jug dhe me dritare te vogel ne murin jugor. Ai ka ne anen perendimore porten e mbuluar me arkitrare te rrafshet dhe dy dritare anash. Naosi ka planimetri ne formen e kryqit me krahet lindore dhe perendimore me te gjate se ata veriore dhe jugore. Objekti ka konstruksion me mure mbajtes. Muri eshte ndertuar me gure zakonshem duke patur edhe copa tullash. Si lidhes eshte llaci i gelqeres. Kultura e perdorur ne kete konstruksion eshte e tipit bizantin ne te cilin jane perdorur dhe kolona cilindrike guri ne arkaden e hajatit. Mbulesa eshte me cati me tjegull vendi.

### *Peisazhi i mbrojtur "Vjose-Narte"*

Zona e Peisazhit te Mbrojtur (ZPM) Vjose-Narte (Kategoria e IV IUCN) eshte nje kompleks ligatinor qe shtrihet ne Rajonin e Vlores. Vete zona mbulon nje siperfaqe prej 19738 hektarësh. Lartesia e kompleksit varion nga 0-246 m mbi nivelin e detit. Pika me e larte ndodhet midis fshatrave Hoshtime dhe Llakatund. Potencialet qe e bejne Vjose-Narten per t'u shpallur Peisazh i Mbrojtur ne Shqiperi jane:

Vjose-Narta eshte nje zone me rendesi nderkombetare. Peisazhi i Mbrojtur Vjose – Narte perfshihet ne rrejetet ekologjike: Zone kandidat Emerald nen Konventen e Bernes si "Peisazh i Mbrojtur i kompleksit ligatinor Vjose - Narte" (ID AL0000008, siperfaqe: 19.412,00 hektare, "Peisazhi i Mbrojtur i sistemit ligatinor Vjose-Narte "). Per me teper, siti njihet si Zone e Rendesishme per Shpendet e quajtur "Laguna e Nartes" me ID "AL005" pasi ploteson kriteret A1, A4i, A4iii, B1. Ajo njihet si Zona Kryesore e Biodiversitetit (KBA) ne nivel global e emeruar "Vjose - Narta (Vjose-Pishe Poro-Laguna e Nartes)" me ID ALB24. Zona permbush kriteret Ramsar per numrin e pergjithshme te shpendeve te ujit dimerues me me shume se 34 000 individe (Kriteri Ramsar eshte 20 000 individe). Per tre lloje, zona strehon me shume se 1% te popullates rajonale. Keto te dhena jane te mjaftueshme per ta listuar Vjose-Narten si nje nga zonat me te rendesishme per shpendet ne Shqiperi dhe Rajonin Mesdhetar Lindor. 92 lloje i perkasin grupit te llojeve te vyera.

Narta eshte ligatina e dyte me e madhe ne Shqiperi. Ajo mban nje numer te madh llojesh, veçanerisht shpend dimerues. Laguna e Nartes eshte zona e dyte me e rendesishme dimeruese dhe folezuese per shpendet e ujit ne Shqiperi.

Vjose-Narta strehon 26 lloje Globalisht te Rrezikuara dhe eshte keshtu nje zone ruajtja e se ciles ka nje interes mbare boteror. Pervec kesaj, kompleksi regjistron 189 lloje te Rrezikuara ne Shqiperi, fakt qe e rendit ate ne nje zone te vyer e cila meriton te ruhet me kujdes. Rendesia e zones tregohet gjithashtu nga prania e 118 llojeve te mbrojtura ne shkalle kombetare dhe nderkombetare.

WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA



Kompleksi Vjose-Narte eshte nje zone e mirenjohur per floren e veçante dhe larmine e habitateve. Te gjitha keto lloje perbejne nje tipar te rendesishem kombetar me vlera te veçanta ekonomike dhe shkencore. Disa lloje jane shume te rralla per Shqiperine, te tjere kane vlera te rendesishme shkencore, dhe nje numer i larte llojesh perdoren gjeresisht ne ekonomi si bime mjeksore, aromatike, industriale dhe dekorative. Ne peizazhin e mbrojtur Vjose-Narte jane evidentuar 114 bime aromatike mjekesore.

Zona dallon per vlerat e saj ekologjike, historike, dhe arkeologjike, larmine e habitateve dhe mozaikun e pejsazheve. Llojet me vlere dhe habitatet e bejne ate shume terheqese per edukim dhe ndergjegjesim publik te nxenesve te shkolles, studenteve, publikut ne pergjithesi dhe madje edhe vendim-marresve. 3

Prania e pese Monumenteve Natyrore, Manastiri i Zvernecit (nje nga zonat me te vizituara, nje atraksion shume terheqes per qytetin e Vlores) dhe zones arkeologjike te Treportit i japin te gjithe zones vlera te tjera shtese ne aspektin kulturor dhe eko-turistik, duke e bere ate te rendesishme ne shkalle lokale dhe kombetare.

Zona Vjose-Narte ka qene dhe ende eshte nje qender kerkimi per shume institucione shkencore dhe edukative te tilla si Universiteti i Vlores, Universiteti i Tiranës, Instituti i Hidraulikes, Instituti i Hidrologjise dhe Meteorologjisee, Instituti i Kerkimeve Biologjike, Instituti i Tokave etj. Fushat shkencore te mbuluara nga keto institucione perfshijne hidrauliken, hidrologjine, gjeomorfologjine, socio-ekonomine dhe biologjine (zologjine dhe botaniken)

Kjo zone gersheton nje larmi kushtesh te pershtatshme per zhvillimin e turizmit si klime te shendetshme dhe kushte sociale e ekonomike te favorshme. Zona eshte e famshme per pasurite e saj natyrore dhe kulturore te cilat mund te mbeshtesin aktivtete eko-turistike te shumta te tilla si shetitje (Kallenga dhe Rezervati i Menaxhuar i Pise-Poros), vrojtime shpendesh ne lagunën e Nartes dhe ne Kriporet, turizem kulturor ne zonat historike te Zvernecit dhe te Treportit


Kufijte e ZPM jane si me poshte:

Ne Veri – Lumi Vjosa deri ne fshatin Mifol,

Ne Lindje – Vija qe lidh majat e kodrinave "Mishikarta", "Cecai", "Cipllaku", "Kisha", "Mutreva" dhe "Babica e Vogel",

Ne Jug – Vija qe lidh fshatin e Nartes me fshatin e Zvernecit (Pusi i Mezinit – Fusha e KriporesPylli i Sodes),

Ne Perendim – Deti Adriatik (Vjose -Treporti). PM shtrihet ne territorin e dy Njesive Administrative: Njesia Administrative Novosele ne veri te saj dhe Njesia Administrative Qender ne jug dhe 18 fshatra



(Zverrnec, Narte, Panaja, Oshtime, Kerkove, Bestrove, Aliban, Poro, Novosele, Mifol, Cerkovine, Skrofotine, Fitore, Trevllazer, Akerni, Bishan, Delisuf, Dellinje) me nje popullsi prej 24 000 banoresh.

Qyteti me i afert eshte Vlora, nje prej qyteteve me te medha te Shqiperise me nje popullsi prej 106 000 banore. Disa prej mjediseve kryesore te Vjose-Nartes jane ligatinat, tokat bujqesore, pyjet dhe zonat urbane (Tabela 1). Mjediset ligatinore zene 37% te siperfaqes se pergjithshme. Mjedisi tjetër kryesor eshte toka bujqesore qe ze afro 33% te siperfaqes. Pyjet perbejne habitatin e trete dhe mbulojne 6% te territorit.

Pjesa qendrore e ZPM eshte laguna e Nartes, nje lagune e ceket prej 2 900 hektarësh, rrethuar nga kodra ne pjesen jugore dhe lindore, toke bujqesore ne veri dhe dy laguna te vogla ne veri-perendim.

Nenzonat kryesore ne brendesi te kompleksit jane: Laguna e Nartes dhe kriporet, Ish-rezervati i Pise-Poros, Lagunat e Kallenges, Kodrat e Panajase dhe Fusha e Akernise.

#### *Laguna e Nartes*

Narta eshte siperfaqja ujore kryesore e zones. Pjesa veriore e e saj transformua ne kripore te cilat sot mbulojne nje siperfaqe prej afro 1 500 ha. Kriporja dhe lagunat ndahen nga nje dige prej 13.8 km<sup>2</sup>.

Laguna e Nartes (2 900 ha) ndahet nga deti prej nje brezi ranor, i mbuluar ne pjesen me te madhe te tij prej pyllit te pishave. Laguna komunikon me detin nepermjet dy kanaleve artificiale. Kanali jugor eshte 200 m i gjate, 6-48 m i gjere dhe 0.2 -1.8 m i thelle. Kanali verior eshte 800 m i gjate, 11-60 m i gjere dhe 0.3-0.5 m i thelle. Kanali ka nje debit prej 2.2 – 4.3 m<sup>3</sup>/s. Te dy kanalet bllokohen shpesh per shkak te mbushjes nga sedimentet.

Laguna ka nje thellesi mesatare prej 1.2 m. Thellesia maksimale arrin 2.08 m ndersa thellesia minimale eshte 1.08 m. Si cdo lagune tjetër edhe ketu regjimi ujqor eshte ne varesi te batice-zbatice. Nje ndikim te madh kane edhe ererat. Era jugore ul nivelin e lagunes me 20-25 cm ndersa era e veriut ngre nivelin me 15-20 cm. Uji i lagunes eshte teper i kripur me shifra qe ne pikun e veres kapin vleren 78.0 0/00. Gjate dimrit kripesia zbret ne 36 0/00 dhe eshte e ngjashme me detin Adriatik. Pjesa lindore e lagunes e cila ndikohet pak nga ujerat detare, shfaq luhatje te theksuara te kripesise. Ujerat e lagunes jane pakalkaline (pH 8.4-8.8). Sasia e Oksigjenit te tretur varion midis 5-10 mg/l. Kur sasia e ujqit te embel eshte mjaft e ulet vecanerisht gjate veres) dhe kur kanalet e komunikimit jane te bllokuara nga mbushjet, nje siperfawe prej afro 1 000 ha thahet ndersa nje pjese tjetër prej afro 800 ha kap nje thellesi prej 10 cm. Kjo thatesire eshte mjaft e demshme per bioten e lagunes.

#### *Pishe-Poro*

Pishe-Poro, deri ne 2004 nje Rezerve Natyrore e Menaxhuar perfaqeson duna ranore te mire zhvilluara (deri ne 6-8 m lartesi) si dhe bimesi psamofite, higrofile dhe halofite. Pjesa kryesore e rezerves

mbulohet nga pylli i pishes. Nje pjese e dunave ranore te Pise-Poros jane shkaterruar si pasoje e marrjes se paligjshme te reres. Megjithe demtimet e mesiperme, ish Rezerva Natyrore e Menaxhuar eshte akoma ne gjendje te mire. Pjeset e degraduara te saj mund ta rrimarin veten nese behen nderhyrjete duhura.

### *Kallenga*

Kallenga eshte nje lagune e ceket prej 450 ha. Lidhet artificialisht me detin nepermjet nje kanali qe eshte hapur vetem kohet e fundit. Perdoret per peshkim me rrjeta nderkohe qe se fundi ne gryken e kanalit eshte ndertuar dhe nje dajlan.

### *Kodrat e Panajase*

Kodrat e Panajase shtrihen ne pjesen lindore dhe jugore te ZPM. Pika me e larte arrin 246 m dhe ndodhet midis Trevllazerit dhe Llakatundit. Makia mesdhetare dhe pylli i dushkut dikur tipike per kete zone, sot jane zevendesuar nga ullishtat.

### *Kriporet*


Perfshin pjesen e dikurshme veriore te lagunes se Nartes e transformuar ne Kripore ne fillimet e viteve 50'. Siperfaqja e sotme eshte afro 1 500 hektare. Perbehet nga shume pellgje te ceket ne brendesi te te cilave ka diga dhe ishuj te vegjel qet i kthejne kriporet ne vende teper interesante per shpendet e ujit folezues.

### *Fusha e Akernise*

Shtrihet ne veri te lagunes se Nartes dhe kriporeve. Dikur nje toke kenetore, sot kjo hapesire eshte zevendesuar nga toka bujqesore. Deri ne fillimin e viteve 90', fusha mbulohej nga nje rrjet i kompletuar ujitjeje dhe kullimi. Me pas, nje pjese e mire e rrjetit te ujitjes dhe kullimit u shkaterrua. Nje pjese e madhe e tokes se dikurshme bujqesore sot eshte braktisur ose perdoret per kullotje.

### **Vlera historike dhe arkologjike te zones**

Vlerat historike dhe arkeologjike te zones, sic eshte permendur me lart jane unike dhe me interes per tu vizituar dhe shijuar. Por keto vlera duhet te ruhen, theksohen, dhe te lejohet hyrja dhe perdorimi per vizitoret. Disa prej ketyre vlerave, te tilla si Manastiri i Zvernecit kane nevojte per nderhyrje rehabilituese ne menyre qe te restaurohen dhe te vihen ne pah vlerat e tyre dhe te behen me terheqese per vizitoret.



### *Kisha e Shen Merise*

Ndodhet ne ishullin e Zverrnecit, ne pjesen jugor te lagunes se Nartes. Esht nje Monument Kulture qe daton nga shekulli i 13te. Kisha eshte e mirenjohur per pikturat murale, si dhe gdhendjet ne dru qe tregojne lule dhe kafshe te ndryshme. Kisha sot eshte restauruar dhe perdoret sin vend kulturi. Cdo 15 Gusht ne ishullin e Zverrnecit organizohet festa e vitit, sigurisht me origjine fetare.

### *Triporti*

Gjendet ne perendim te lagunes se Nartes, ne afersi te fshatit Zverrnec. Germimet arkeologjike kane treguar se zona ka ndertesa antike qe datojne nga periudha greko-romake. Triporti ka qene nje port i rendesishem qe lidhte qytetin e qendra te tjera antike si Aulona, Apollonia, Oriku dhe Amantia.

### *Spinarica*

Dipas dokumenteve te Shekullit te 12te, Spinarica ishte nje nga qytetet mesdhetare te Detit Adriatik. Gjendej ne afersi te lagunes se Nartes, ne grykederdhjen e Lumit Vjosa. Spinarica ishte nje qender e rendesishme tregtare vecanerisht per dritherat, gjene e gjalle, leshin dhe hekurin. Pas shekullit te 15te,qyteti humbi rendesine e vet dhe nuk permendet me nga dokumentet historike. Rrenojat e tij nuk jane zbuluar ende per shkak te ndryshimeve te medha natyrore dhe njerezore ne zonen bregdetare.

WASH & GO Laundry  
NIPT: L97008205L  
VLORE - ALBANIA

## VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimeve negative ne mjedis analizohet gjate fazes se funksionimit te aktivitetit "Wash & Go Laundry". Per vete natyren e veprimtarise dhe teknologjise inovative qe ka ky aktivitet impaktet negative vleresohen te jene te larta ne fazen e funksionimit.

Vleresimi i impakteve kryhet ne baze te teknologjise qe operone ky subjekt. Ne vijim do te studjojme impaktet negative qe implementohen nga ky aktivitet per parametra te ndryshem mjedisore.

### ➤ **Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones**

Ne karakteristikat fizike nuk perfshihen ndryshime ne topografine e siperfaqes ku zhvillohet aktiviteti. Instalimet jane egzistuese dhe vete natyra e aktivitetit nuk ndikon ne ndryshime fizike te zones. Ky aktivitet i kryen te gjitha proceset brenda ambjenteve te katit te pare te nje objekti shumekatesh mare me qira nfa shoqëria, duke mos ndikuar negativisht ne karakteristikat fizike te zones.

### ➤ **Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit**

Objekti ndodhet ne zonen urbane te qyteti te Vlores. Perreth tij nuk kemi prezence te flores dhe faunes. Te vetme bimesi mund te perendim druret dhe shkurret dekorative qe jane te mbejlla ne ane te trotuareve per gjelberimin e zones.


## **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve**

### ▪ **Shkarkimet ne ajer**

Nga aktiviteti i larjes se rrobave nuk gjenerohen pluhura nga pajisjet dhe makinerit qe zhvillohen proceset e punes; si makinerite e larjes, tharjes dhe hekurosjes. Ne kete aktivitet nuk ka asnje proces qe shoqërohet me gjenerim pluhurash. Te vetme pluhura mund te jene te pranishme nga rrobat e papastra gjate procesit te futjes se tyre ne lavatrice. Sasia e tyre eshte shume e vogel duke ju permbajtur normave te lejuara.

### ▪ **Shkarkimet ne uji**

Nga aktiviteti i larjes se rrobave nuk gjenerohen ujra me natyre toksike. Ujrat qe gjenerohen nga procesi teknologjik i larjes se rrobave jane me natyre urbane te cilat nepermjet sistemit te tubacioneve se bashku me ujrat qe dalin nga ambjentet higjieno-sanitare shkarkohen ne sistemin e kanalizimit te qytetit te Vlores. Ky aktivitet nuk ndikon ne ndotjen e ujrave nentokesore apo siperfaqesore. Ndikime do te kishte ne rast te shkarkimit te tyre ne menyre te pa kontrolluar ne toke.



▪ **Prodhimi i mbetjeve**

Mbetjet qe gjenerohen nga ky aktivitet jane:

- Mbetjet me natyre urbane qe gjenerohen nga aktiviteti jetesor i punonjesve ku perfshihen plastika, qelqi, metali, etj. Keto mbetje grumbullohen nepermjet koshave qe ndodhen ne ambientet e aktiviteti dhe prej andej do te transportohen drejt vendit te depozitimit te mbetjeve urbane.
- Mbetje nga perfundimi i detergjenteve jane bidona te madhesive te ndryshme te cilat meren nga individe per perdorim vetijak ose individ te cilet grumbullojne plastika per riciklim.

➤ **Emetimi i zhurmave**

Nisur nga teknologjia inovative qe perdor ky subjekt, ku te paisjet jane te certifikuara sipas standarteve europiane, gjenerimi i zhurmave dhe vibrimeve eshte ne nivele shume te uleta gati te pa perfillshme per banoret e zones.

➤ **Prani te zjarrit**

Prani te zjarrit mund te kemi vetem si pasoj e shendijave elektrike dhe shkendijave ne pajisjet dhe makinerit qe punojne me gaz. Subjekti ka ndertuar nje sistem te furnizimit me gaz te nje sigurie te larte dhe ka mare masa duke vendosur ne ambientet e aktivitetit pajisje kundra zjarrit.



## MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT

### Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

#### a) Planifikimi i zones

Zhvillimi i aktivitetit behet sipas projektit duke ruajtur radhen e puneve, grumbullimin e mbetjeve, diferencimin e tyre dhe transportin e tyre drejt destinacionit perkates.

#### b) Masat teknike

Per nje ecuri sa me te mire te puneve ne subjekti parashikon cdo vit te kryej punimet e meposhtme:

- Remot te plote te makinerive dhe pajisjeve qe kryejne proceset e larjes se rrobave.
- Mirembajtja e sistemit te furnizimit me gaz te makinerive.
- Mirembajtja e sistemit te furnizimit me uje te makinerive.
- Pastrim, lysterje dhe riparim te mjediseve te brendshme dhe te jashteme te objektit.
- Sistemime e rregullime dhe mbjellje bimesi dekorative te cilat i pershtaten ambjeteve te brendshme.

#### c) Masat estetike dhe ekologjike


Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti subjekti do te kryej proceset e meposhtme:

- Mirembajtjen e objektit
- Sistemimin e mbetjeve qe dalin nga procesi i prerjes jetesor i punonjesve dhe mbajtesit e detergjenteve.
- Subjekti te respektojte te gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar ne kete Formulare-Kerkese per Leje Mjedisore Tipi B
- Subjekti te respektojte dhe zbatoje kushtet teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri.
- Mbajtja e higjenes se larte te ambjeteve te lavanderise.

#### d) Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Per administrimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duhet te marre keto masa:

- Mbetjet dalin nga punonjesit, duhet te largohen ne menyre korekte nga ambjentet e punes dhe te dergohen drejt destinacionit perkates.
- Mbetjet nga boshatisja e detergjenteve (bidona plastik) pasi grumbullohen ne ambjentet e lavanderise tu dorzohen personave te cilet jane te intersuar per perdorimin e tyre.



### **e) Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit**

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton aktiviteti te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara duhet te merren keto masa:

- Ambientet rreth e rrotull aktivitetit duhet te mbahen te pastra ne menyre te tille qe te shmanget ngritja e pluhurave.
- Te kryhet ventilimi i ambienteve ku kryhen procese e larjes se rrobave.
- Te mbillet bimesi dekorative duke ju pershtatur ambienteve te brendshme te lavanderise.

### **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbatuese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permirsimi i vazhdueshem, sipas kushteve teknike te punes ne zbatim te proceseve te larjes se rrobave.


### **Plani i emergjencave**

Plani i emergjencave eshte nje nder planet kryesore me qellim parandalimin dhe mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve, komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Personeli i ketij projekti duhet te njoh mire te gjitha proceset qe kryhen ne kete projekt ne menyre qe te arrije te kuptoje situaten, shkaqet dhe te jete i pergatitur per menaxhimin e avarive apo aksidenteve. Ne rast se gjendemi para nje aksidenti personat me te afert duhet te japin shenjen e alarmit. Ne varesi te llojit dhe madhesis se aksidentit do te kryhet izolimi.

### **Masat per parandalimin e avarive dhe aksidenteve ne frontin e punes jane:**

- Perdorimi i mjeteve dhe paisjeve te cilat jane ne gjendje te mire teknike
- Servisim periodik i pajisjeve dhe makinerive ne frontin e punes
- Çdo person para se te nisi punen ne kete projekt ti nenshtrohet trajnimit per te njohur gjitha procesin teknologjik, per tu njohur me rrezikun e aksidenteve dhe reagimin e tij ne cdo rast emergjent.
- Ne objekt te ndertohet kendi i ndihmes se shpejte dhe te jete i njohur nga te gjitha personat e punesuar.
- Ne objekt te vendosen tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe te rrezikut, te publikohen numrat e kontaktit te supervizorit te emergjencave.
- Zona te jete e rrethuar per te evituar hyrjen e personave te pa autorizuar.
- Te jete ndertuar sistemi i tokezimit





### **Trainimi i Personelit**

- Trainimi do te mbuloje aspektet e shendetit dhe sigurise gjate kryerjes se proceseve te punes. Trainimi mjedisor do ti referohet kushteve aktuale mjedisore, ndikimeve potenciale mjedisore te punes qe do te behet dhe zbatimit te masave specifike parandaluese per eliminimin apo minimizimin e ndikimeve negative.
- Nje plan trainimi do te zhvillohet per te siguruar se personeli perkates ka marre trainimin e duhur dhe kompetencat per kryerjen e punes se tij.

Subjekti eshte i detyruar qe ne rast aksidentesh te njoftoje institucionet perkatese per menaxhimin e situatave me qellim zvogelimin e impakteve mjedisore dhe rrezikut qe mund te preke jeten e punonjesve apo dhe banoreve.

